



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1485/ 3 prot

Datë 22.07.2022

**V E N D I M**  
**Nr.689 /2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22 .07.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-34337-06-27-2022 me objekt “*Blerje materiale ndertimi*”, me fond limit 4,255,860.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës.

**Ankimues:** “Bajro Bros” SHPK  
*Rr. Riza Cerova, Pallati Colombo 2, Tiranë*

**Autoriteti kontraktor:** Agjencia e Shërbimeve Publike Berat  
*Rruga Baki Gjebrea, Lagjia nr. 1 Berat*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nënit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.06.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-34337-06-27-2022 me objekt “*Blerje materiale ndertimi*”, me fond limit 4,255,860.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

II.2. Sipas verifikimeve në sistemin e prokurimit elektronik autoritet kontraktor me datë 04.07.2022 ka publikuar një shtojcë për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, në përmbajtjen e së cilës në mënyrë të përmbledhur është parashikuar:

“ **Ishte** 2.3.2 Me qëllim realizimin e objektit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dëshnojë se ka në pronësi ose me qira:

-minimalisht 1 (nje) kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 7.5 (shtatë pikë pesë ton)

.....

#### **Bëhet:**

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë një automjet të përshtatshëm për transport të mallrave objekt-prokurimi, minimalisht 1 (nje) kamion me vinç me kapacitet mbajtës mbi 3.5 (tre pikë pesë) ton për të cilin duhet të paraqese dokumentet e mëposhtme:

.....

II.3. Në datën 12.07.2022 operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, konkretisht të shtojcës së ngarkuar nga autoriteti kontraktor me datë 04.07.2022.

II.4. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Nëpërmjet shkresës me numër 513/6 prot., datë 15.07.2022 protokolluar me tonën numër 1485/2 prot., datë 18.07.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK dhe ka njoftuar atë dhe Komisionin e Prokurimit Publik se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

II.7. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka pranuar si më poshtë: *“[...] Hiqet kriteri që mjeti të jetë 3.5 ton por mjafton që të jetë mjet veteshkarkues me vinc. Për realizimin në kohë dhe sipas kërkesave të AK për objektin e prokurimit duke pasur parasysh dhe zërat e preventivit.”*

II.8. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik vihet re se me datë 15.07.2022 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën me ndryshime sipas pretendimeve që i ka pranuar operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Në datën 28.06.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-34337-06-27-2022 me objekt *“Blerje materiale ndertimi ”*, me fond limit 4,255,860.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

III.2. Sipas verifikimeve në sistemin e prokurimit elektronik autoriteti kontraktor me datë 04.07.2022 ka publikuar një shtojcë për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi në përmbajtjen e së cilës në mënyrë të përmbledhur është parashikuar:

*“ Ishte 2.3.2 Me qëllim realizimin e objektit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira:*

*-minimalisht 1 (nje) kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 7.5 (shtatë pikë pesë ton)*

.....  
**Bëhet:**

*2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë një automjet të përshtatshëm për transport të mallrave objekt-prokurimi, minimalisht 1 (nje) kamion me vinç me kapacitet mbajtës mbi 3.5 (tre pikë pesë) ton për të cilin duhet të paraqese dokumentet e mëposhtme:*

.....  
III.3. Në datën 12.06.2021 operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, konkretisht të shtojcës së ngarkuar nga autoriteti kontraktor me datë 04.07.2022.

III.4. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.5. Nëpërmjet shkresës me numër 513/6 prot., datë 15.07.2022 protokolluar me tonën numër 1485/2 prot., datë 18.07.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK dhe ka njoftuar atë dhe Komisionin e Prokurimit Publik se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

III.7. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar si më poshtë: “[...] *Hiqet kriteri që mjeti të jetë 3.5 ton, por mjafton që të jetë mjet vetëshkarkues me vinc. Për realizimin në kohë dhe sipas kërkesave të AK për objektin e prokurimit duke pasur parasysh dhe zërat e preventivit.*”

Sa më lart Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe do të vazhdojë shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, konkretisht duke pretenduar “[ Së dyti, kërkesa e AK për paraqitjen e minimalisht një kamion me vinç është shumë diskriminuese dhe selektive sepse transporti i mallrave të preventivit mund të bëhet edhe me kamiona Jo detyrimisht të pajisura me vinç sepse të gjithë artikujt e preventivit, mund të shkarkohen me krahë nga punonjësit tanë të regjistruar si punonjës ngarkim-shkarikimi ose nga punonjës të marrë me kontratë në momentin e duhur. Kërkojmë modifikimin e kësaj kërkesë duke hequr përcaktimin detyrues të vinçit]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve të tenderit, pika 2.3.2. “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë një automjet të përshtatshëm për transport të mallrave objekt-prokurimi, minimalisht 1 (nje) kamion me vinç me kapacitet mbajtës mbi 3.5 (tre pikë pesë) ton për të cilin duhet të paraqese dokumentet e mëposhtme:.....”*

III.8.2. Në kthimin e përgjigjes në lidhje me këtë pretendim autoriteti kontraktor ka argumentuar se: “ Lidhur me pikën 2 të ankesës ku kërkohet që të hiqet mjeti vetëshkarkues theksojme, se kjo pikë nuk merret parasysh pasi materialet janë të rënda”.

III.8.3. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin, vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.8.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

III.8.5. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, përgjigjes së autoritetit kontraktor si dhe pas verifikimit të zërave të përcaktuar të “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” rezulton, se një numër i konsiderueshëm i zërave janë materiale të rënda, si dhe të përcaktuara në sasi të mëdha sipas nevojave të autoritetit kontraktor, të cilat nuk mund të ngarkohen dhe shkarkohen nga punonjësit e operatorit ekonomik të përcaktuar për këtë qëllim (krahu i punës), por nga mjete që perdoren për ngarkim dhe shkarkim të mallrave. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (mjete të ngarkim shkarkimit në rastin konkret), në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim realizimin me sukses të saj. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Në këtë rast Komisioni gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik në lidhje me disponimin e 1 (nje) kamion me vinç për shkarkimin e mallrave për të cilin duhet të paraqesë dokumentet e kërkuara nga autoriteti kontraktor është në përputhje me natyrën e kontratës, volumin e saj, si dhe me natyrën e zërave të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit. Në këtë kuadër, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese, si dhe të jenë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe sektorial në fuqi. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se përcaktimi i bërë nga ana e autoritetit kontraktor “*Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë një automjet të përshtatshëm për transport të mallrave objekt prokurimi, minimalisht 1 (nje) kamion me vinç*”, është parashikuar në përputhje me kërkesat ligjore si më sipër cituar, si dhe me volumin dhe përmasat e kontratës prandaj, Komisionin e gjen të drejtë vendimin e autoritetit kontraktor për hartimin e kriterit si më sipër cituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-34337-06-27-2022 me objekt “Blerje materiale ndertimi”, me fond limit 4,255,860.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-34337-06-27-2022 me objekt “Blerje materiale ndertimi”, me fond limit 4,255,860.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.
  3. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**